



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1320 prot.

Tiranë, më 28. 12.2023

V E N D I M

Nr. 258, Datë 28 . 12 . 2023

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 260, datë 11.02.2023, të paraqitur nga Punonjësit e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, kundër Këshillit të Ministrave, të cilët pretendojnë diskriminim në pagë.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesit informojnë se: “Ne punonjësit e Institucionit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, ju drejtohem ju duke marrë shkas nga diskriminimi në pagë që na është bërë si shkak i VKM nr.919, datë 25.11.2020, botuar në Fletoren Zyrtare 208/2020. Nga njëra anë, bazuar në ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave”, i ndryshuar, nenit 41 germa a,b,c, pika 2; neni 43, 44, 45, 46, 47, 48, 50 pika 1, 2, ligji nr.7961 datë 12.07.1995 i Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, neni 7, Kreu XI, V.K.M nr. 919/20202 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.187, datë 08.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të Nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike, ligji nr.10221, datë 04.02.2010, ndryshuar me ligjin nr.124/2020, neni 2 germa a, b, c, neni 7 i po i këtij ligji pika 1; Neni 12 germa b, c të po këtij ligji dhe sipas ligjit nr. 98/2016, punonjësit me statusin e nëpunësit civil gjyqësor dhe punonjësit e tjerë në gjykata gëzojnë të njëjtin status për të njëjtat pozicione pune dhe nivele kualifikimi.

Nga ana tjetër VKM nr.919/2020 për po të njëjtët kategori ka vendosur diskriminimin në paga për të njëjtat kategori pozicionesh pune që sipas ligjit janë të njëjtat në të gjitha shkallët e gjyqësorit, konkretisht:

- Lidhja 4/1 e VKM-së nr 919, datë 25.11.2020, ka bërë ndarjen në kategori të ndryshme që diskriminojnë hapur punonjësit e gjyqësorit.

Ndërkohë në ligjin nr. 98/2016 shprehet se Administrata Gjyqësore është e njëjtë dhe i shërben të njëjtit nivel gjyqtarësh në sistemin e drejtësisë. Për Gjykatat e Niveleve të Para sipas ligjit, gjyqtarët janë të të njëjtës kategori, gjyqtarët e shkallës së parë të cilido niveli trajtohen njëllor në pagesa referuar ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve, po kështu dhe gjyqtarët e gjykatave të apeleve”. Ndërsa punonjësit që i shërbejnë dhe i mbështesin në veprimtarinë administrative dhe gjyqësore diskriminohen dhe niveli i pagave shkon në nivel zbritës, shkon me rend zbritës të niveleve të pagave është diskriminim i hapur, i pabazuar në ligj.

Ligji nr. 98/2016 i trajton në mënyrë të barabartë gjithë punonjësit civilë gjyqësorë brenda sistemit të drejtësisë, me status të njëjtë, për të njëjtën kategori pozicionesh pune. E kundërta ndodh sipas VKM nr.919/2020, për ndarjen e niveleve të punonjësve të administratës gjyqësore, dhe po kështu edhe me strukturën e pagave sipas VKM nr. 325, datë 31.05.2023. Për këtë kërkojmë mbrojtjen nga diskriminimi dhe shpalljen si të pavlefshme nga ana tuaj, Lidhjen nr. 4, të VKM nr. 919, datë 25.11.2020, e cila diskriminon haptazi në pagesë gjithë nëpunësit civil gjyqësor të kësaj gjykate dhe të gjykatave të tjera në Republikën e Shqipërisë.

Theksojmë këtu se një pjesë e gjykatave trajtohen me status të posaçëm siç janë Gjykatat e Posaçme, ndërsa niveli i gjykatave shërben dhe duhet të shërbejë për ecurinë e gjyqtarëve por jo për diskriminimin e personelit administrativ të administratës gjyqësore. Sipas ligjit nr. 98/2016, jemi në të njëjtin status dhe sipas VKM-së po diskriminohemi haptazi duke mos përfitur pagën në mënyrë të barabartë.

Me zhvillimet në sistemin gjyqësor në zbatim të hartës së re gjyqësore jemi diskriminuar edhe për faktin se duke u kategorizuar në nivele më poshtë sesa kolegët e gjykatave të kryeqytetit që janë niveli I (parë) dhe që atë status dhe pagesë po e përfitojnë vetëm për shkak të kësaj VKM-je, ne nuk na është dhënë mundësia që brenda sistemit gjyqësor të aplikojmë për ngritjen në karrierë vetëm sepse nga gjykatat e kryeqytetit dhe niveleve të dyta të paktën, deri tani nga të gjitha shpalljet për vendet e lira të punës brenda sistemit gjyqësor, dhe me lëvizjet paralele jemi diskriminuar, pasi kjo VKM na ka çuar automatikisht në kategorinë e tretë të nivelit të gjykatave. Ndërkohë përballë ligjit dhe VKM prevalon ligji dhe jo VKM-ja. Sipas ligjit nr. 98/2016 jemi të barabartë ndërsa sipas VKM nuk jemi. Ndërkohë sipas VKM nr. 325, datë 31.05.2023 është përcaktuar përsëri kategoria e ulët dhe diskriminuese për punonjësit e kësaj gjykate, për efektet e pagave sipas pozicioneve të punës”.

Ankuesit, kërkojnë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe shpalljen të pavlefshme të Lidhjes nr. 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 919, datë 25.11.2020, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 208, datë 27.11.2020.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 3, i ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut, dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Referuar informacionit të cituar në ankesë dhe materialeve bashkëngjitur saj, rezulton se periudha e ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është në muajin nëntor 2020, fakt i cili është pohuar dhe nga vetë ankuesit gjatë parashtrimit të fakteve. Ndërkohë që, edhe periudha e konstatimit të diskriminimit nga ana e ankuesve është në muajin nëntor 2020, periudhë në cilën ankuesit kanë filluar të paguhen me kategorinë e pagave të reja të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 919, datë 25.11.2020, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 208, datë 27.11.2020.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është muaji nëntor 2020, kur janë aplikuar pagat e reja për punonjësit dhe rrjedhimisht daton edhe me momentin e marrjes dijeni nga ankuesit për diskriminimin në pagë të pretenduar nga ana e tyre.

Ndërkohë që, data e depozitimit të ankesës pranë KMD-së është 30.11.2023. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit daton më shumë se 3 (vjet) nga

ndodhja e diskriminimit të pretenduar. Njëkohësisht, edhe momenti, i marrjes dijani mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 260, datë 11.12.2023 pranë KMD-së.

Në nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Ankesa nuk pranohet kur: (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuuese”*. Parashikimi i sipërcituar nuk është kumulativ dhe kërkon si kriter për mospranimin e ankesës, plotësimin e njërit prej kushteve të mësipërme.

Pra, konkludojmë se ankesa është në tejkallim të afateve ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹.

Ndërkohë referuar nenit 36, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, është parashikuar se: *Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijani për këtë sjellje, pika 3. Gjykata e njofton komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim dhe pika 4, prarashikon se: Gjykata mund t'i kërkojë komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen.*

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 260, datë 11.12.2023, të paraqitur nga Punonjësit e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, pasi është paraqitur tej afateve ligjore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

¹ Për analogji shih vendimet nr. 64, datë 27.04.2023 dhe nr. 139, datë 26.07.2023 të Komisionerit.

Robert GAJDA